

# NEWSLETTER

Nëntor

**Pensione më të larta?  
Korbi: Mund të përfitohen  
përmes skemës private**

**Albsig mbështet sportistin  
Jurgen Çika, kampion  
Europë në boks**

**Me një klik,  
bli sigurimet  
në Albsig dhe përfito  
ofertat e fundvitit.**

**E bukura e festave të nëntorit nga Albsig,  
nis me super ofertë paketa festive  
për të gjithë familjen e biznesin.**



**ALBSIG**

PJESË E



**KASTRATI GROUP**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

#### **VIZIONI**

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

#### **MISIONI**

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

#### **FILOZOFIA**

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





# Partneri juaj i sigurtë!

---



PJESË E  KASTRATI GROUP



## Pensione më të larta? Korbi: Mund të përfitohen përmes skemës private

Lehtësi fiskale, dhe tërheqje të skemave private të Pensioneve, për të gjithë individët e interesuar. Këto do të jenë disa prej benefiteve që pala e interesuar do mund të përfitojë nga miratimi i ligjit të ri për Fondet e Pensionit Privat. Pak ditë më parë Ministria e Ekonomisë bëri me dije se falë një bashkëpunimi me Bankën Botërore dhe Fondin Monetarë ndërkombëtarë, u bë e mundur rishikimi i skemës së pensioneve, në mënyrë që të amortizohet apo të sheshohet diferenca nga indeksi vjetorë, dhe fal kësaj të fundit, ekspertët e fushës kërkojnë që të përfshihet në këtë skenë dhe kolona e tretë, ajo e Fondit të Pensioneve Private.

## **Ka një nisëm nga Qeveria për krijimin e Pensionit Privat. Cfarë përcaktohet përmes këtij ligji që është botuar në fletoren zyrtare i cili ka hy në fuqi në fillim të muajit nëntor?**

Në fillim të muajit nëntor ligji i ri ka hyrë në fuqi. U deshën dy vite për të hartuar këtë ligj që u propozua nga AMF. Një kontribut të madh dhanë Shoqëritë Administruese që kanë eksperiencën e duhur për fondet e pensionit privat. Ky ligj pritet të përmirësojë pikërisht shtyllën e tretë të pensioneve që është Pensionet Vullnetar të pensionit që do bashkë funksionoj me shtyllën e parë të pensioneve që administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

### **Cilat janë risitë e kësaj nisme?**

Ligji që ka hyrë në fuqi dhe pritet që dhe aktet nënligjore të hartohen shpejt për të plotësuar kuadrin rregullator. Ka sjellë përmirësime kryesisht të aspektit tatimor, përfitime tatimore për antarët, ku përfitimi më i madh është zbritshmëria që u lejohet për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurave personale. Nëse me ligjin e mëparshëm çdo anëtarë mund të zbriste deri në 200 mijë lekë nëse ishte nën 50-vjeç ose 250 mbi 50 vjeç nga taksat për kontributin e fondit të pensionit privat me ligjin e ri kjo shumë ka arritur sa paga minimale mujore. Çdo anëtarë mund të zbres nga paga e tij bruto deri në 40 mijë lekë në muaj nga paga e tij bruto dhe nuk i llogariten.

### **Kemi të bëjmë me një skemë të të integruar që nga njëra anë mbulohet edhe nga punëmarrësi edhe nga punëdhënësi. Edhe skemë që paguan punëmarrësi një fond të caktuar mujor që do të shkojë për skemën e Pensionin Privat.**

Qëllimi i punëdhënësve për të anëtarësuar punonjësit e tij në skema profesionale është pikërisht nxitja e tyre për të përfituar të ardhura të larta në moshën e pensionit. Është moshë e pensionit ku njerëzit sdo kenë mjaftueshëm të ardhura për të jetuar dhe pikërisht qëllimi i punëdhënësve që të ruaj standart jetese në kohën e pensionit.

### **A është skema e pensioneve private një mënyrë apo një opsion për të rritur masën e përfitimit mujorë?**

Patjetër që është opsion i duhur skema e Pensioneve Privatënë ditët e sotme. Sot skema e pensioneve shtetërore është shtylla e Parë e Pensioneve. Sot ata që punojnë paguajnë për pensionistet që janë sot dhe pensionin tone do e paguajnë brezat që vijnë pas nesh. Duhet të ketë mjaftueshëm kontribute apo subvencione nga shteti në mënyrë që të kemi të ardhura të mjaftueshme e të vazhdueshme në kohën e pensionit. Kontributet po bien për disa arsye emigracioni, ligjshmëria, dhe shume të tjera. Shteti po

subvecionon një pjesë të kontributeve për pension. Këto subvencione nga shteti do jete me i lartë Sot pensioni mesatar është 15 mijë lekë. Shkalla e zëvendësimit në Shqipëri e të ardhurave para pensionit me moshën e pensionit është vetëm 35% të të ardhurave në pension krahasuar me të ardhurave para pensionit. Nderkohë shkalla e zëvendësimit në vendet perëndimore është 75% mënyrë që një person në pension të ruaj një standart jetese para pensionit.

### **Më parë skema ishte e tillë, paguaje me pak përfitohet më shumë, ndërsa tani paguhet më tepër përfitohet më pak?**

Kjo vjen për shkak të uljes së numrit të kontribuesve. Me herët skema kanë qenë katër kontribues një përfitues sot kjo skemë është 1 me 1,15, dmth një person punon dhe një merr pension.

### **Domosdoshmëri dhe nevojë reformimin e skemës, Skema e Pensioneve private sot vlen për ata që janë pjesë e Tregut të Punës.**

Patjetër ajo synon për ata që janë në marrëdhënie pune. Sot është momenti për të kursyer. Vetëm 1000 lekë në muaj mund të kursesh. Sa më i ri të jesh aty do të nisësh të kursehet për pension. Vlera në kohë e paras të bën të kursesh më shumë pavaresisht të vlerës fillestare të kontributit. Një tjetër përfitim është përfitim tatimor në momentin e tërheqjes. Do të thotë se kontributet përjashtohen nga tatimi qoftë individual qoftë dhe i punëdhënësit por në moshën e pensionit nëse këto kontribute nëse i tërhiqni në formën e pensionit brenda dy viteve. Shteti ka dhënë këtë incentive që të nxisë individët të investojnë për kohën e pensionit mos ti behen barë shtetit në një moment të dytë.

### **Ligji është domosdoshmëri apo kusht nga bashkimi evropian. A do gjej zbatim kjo nisem?**


Ligji i ri i sapo hyrë në fuqi zëvendëson ligjin e vitit 2009 të pensioneve vullnetare. Përmirësim të këtij ligji dhe ka sjell dhe letësira për pensionet private. Zbatueshmëria e plotë për shtyllën e tretë pensionet private vullnetare. Pensionet funksionojnë në tre shtylla kryesore.

# Albsig mbështet sportistin Jurgen Çika, kampion Europë në boks



Jurgen Çika, është i riu kuksian i cili pak vite më parë mori titullin kampion europë në kategorinë profesionale të MMA-së, duke renditur kështu çmimin e 6-të e më të rëndësishëm për sportin që praktikon por edhe për vendin që përfaqëson. Që në vegjëlinë e tij ai ëndërronte ndeshjet në ringun botëror dhe duket se po i plotësohen. Në ndeshjen e fundit i riu me origjinë nga kukësi, u mbështet nga Albsig pjesë e Kastrati group. Albsig ka qenë dhe do të mbetet promotore dhe promovuese e te gjitha sporteve duke perfshire ketu dhe ate të boksit. Numërohen me dhjetra sportiest që janë mbështetur nga Albsig Brenda dhe jashtë vendit. Ndërkaq, kthehemi sërish te Jurgen Çika i riu nga kukësi i cili ishte vetëm 18 vjeç, kur mori titullin kampion Evrope në kategorinë profesionale të MMA. Ky është çmimi i 6-të më i rëndësishëm që ka marrë në këtë sport. Në ndeshjen e mbajtur në Athinë të Greqisë, Jurgen Çika përfaqësonte Shqipërinë mes 40 shteteve të tjera. Ky event kaq i rëndësishëm, jo vetëm për boksierin e ri, por për të gjithë sportëdashësit e këtij sporti u mbështetën nga Albsig, pjesë e Kastrati Grup. Shoqëria e Sigurimeve Albsig gjithmonë është spikatur si mbështetëse e eventeve sportive në të gjitha target grupet e shoqërisë. Albsig sh.a. pjesë e Kastrati Group ka qenë dhe është gjithmonë e hapur ndaj sporteve dhe aktiviteteve në ndihmë të mirëqenies së jetës në komunitet. Albsig promovon Vlera. Jane Vlerat ato që na bashkojnë në ditë të tilla dhe që bëhemi përkrahës dhe promotore të brezave të rinj sportistë dhe artëdashës. Ne duam të jemi opsioni kryesor për zgjidhjen e mundësive Tuaja. Mjafton ta përzgjidhni Albsig si partnerin tuaj dhe garancia juaj në çdo hap do të jetë mëse e sigurtë.

# Bli Online albsig.al




## Me një klik, bli sigurimet në Albsig dhe përfito ofertat e fundvitit.

Ofertat online në Albsig fillojnë që para festave të nëntorit për të kulmuar me festën e Vitit të Ri. E kjo traditë duket se po bëhet vit pas viti nga menaxherët e shitjeve online në Albsig. Ndryshe nga të gjithë tregu shoqëria e Sigurimeve Albsig ka shpallur një strategji për të përthithur sa më shumë klient edhe nga shitjet online. Edhe pse dihet që Albsig nga viti në vit forcon "gurët e themeleve" dhe në shumë produkte kryeson në vendin e parë në treg. Edhe shitjet online i ka focus kryesorë dhe ka nisur t'i zhvillojë sa më shumë dhe ti përshtas për mentalitetin e konsumatorëve shqiptarë. Festat e fundvitit janë dhe sezoni më pikant për të ofruar sa më shumë oferta, zbritje të favorshme dhe kombinime produktesh për target grupe konsumatorësh. Dhe këtë strategji duket se e ka zbatuar më së miri Albsig, pjesë e Kastrati Group. Që para festive të nëntorit për shqiptarët që kanë menduar të festojnë jashtë vendi Albsig ju ofroj sigurimin e shëndetit në Udhëtim me një çmim shumë të favorshëm. Dhe jo vetëm kaq por, Albsig po edukon konsumatorët që të pajisen me sigurime vullnetare. Ofertat e përshtatshme të Shëndetit në Udhëtim janë pasuar me zbritje të konsiderueshme të çmimeve të Sigurimit TPL. Dhe jo vetëm kaq por për ata që kanë menduar të presin sigurimin e makinës online Albsig ka menduar tip ajs me Kartën med Falas dhe tju jap 10% zbritje nga çmimi zyrtar i çdo kategorie automjeti. Ofertat dhe zbritjet me rastin e festive të fundvitit në Albsig duket se spaskan.



## **E bukura e festave të nëntorit nga Albsig, nis me super ofertë e paketa festive për të gjithë familjen e biznesin.**

Festat e fundvitit nisin magjishëm në Albsig. Në ditët më të bukura të vitit përfitoni zbritje çmimesh, paketa dhe ofertë spektakolare për sigurimin e shendetit, shtëpisë, makinës dhe biznesit me kushtet e përzgjedhura me shumë dashuri në ndihmë të çdo konsumatori për të festuar netët festive me sigurinë e duhur për të gjithë familjen, biznesin etj. Edhe për festa, Albsigu nuk ndalet por starton me një buqetë ofertash festive speciale online dhe jo vetëm, për të kaluar sa më të sigurtë momentet kulmore të vitit që lëmë pas. Të gjitha produktet e Albsig janë më elitaret në tregun e sigurimeve, si paketat e sigurimit të shëndetit, sigurimet e automjeteve si ato të detyrueshme edhe ato vullnetare ku mund të ndalemi më së shumti të sigurimi kasko, ku cdo drejtues automjeti i duhet një sigurim i tillë për të mbrojtur automjetin dhe "financat familjare" si dhe të tjera produkte ekskluzivisht në paketën e sigurimit të bizneseve. Ngrohtësia e festave vjen në çdo vatër familjare nëpërmjet Albsig, ku do të "shijoni" sigurimet më fantastike e absolute. Fundviti vjen me oferte e dhurata në Albsig. Prenotoni sa më parë një vit të tërë të mbushur plot siguri duke përfituar nga OFERTA FESTIVE me ulje çmimesh në produkte të ndryshme. Albsig ju pret në çdo dege të autorizuar, kudo në Shqipëri, si dhe në çdo kohë online në faqen zyrtare [eëë.albsig.al](http://eëë.albsig.al)



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)

---

[WWW.ALBSIG.AL](http://WWW.ALBSIG.AL)